



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .02.2024

**MBLEDHJA Nr. 5,  
Datë 22.02.2024, ora 10:00  
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e enjte, datë 22.02.2024, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 5 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 19.02.2024.
2. Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi nga burimet fotovoltaike për vitin 2023.
3. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin janar2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
4. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e draft “Kontratës për diferencën” (CfD).
5. Mbi shqyrtimin e kërkesës së OSHEE sh.a për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr.166, datë 10.10.2016, të bordit të ERE, të ndryshuar.
6. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqatës shqiptare të furnizuesve të energjisë elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 186, datë 06.06.2023.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. për lëshimin e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga impianti “Parku fotovoltai EZ-5 Solar Park”.
8. Mbi njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës, për subjektin “Monting” sh.p.k.
9. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 306, datë 23.10.2023, për dhënien e autorizimit nga ERE, shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse, si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.

10. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 249, datë 13.12.2021, i ndryshuar, në lidhje me plotësimin e kushteve të licencimit nga shoqëria “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k.
11. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**